



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
BIBLIOTEKA KOMBËTARE

**DREJTORI**

1. Drejton gjithë veprimtarinë e institucionit bazuar në legjislacionin shqiptar.
2. Harton strategjinë dhe politikat e zhvillimit të BKSh, si edhe ndjek zbatimin e tyre.
3. Planifikon dhe organizon veprimtarinë e institucionit mbështetur e ndihmuar nga organet kolegjiale këshillimore (Këshilli Administrativ dhe Këshilli Shkencor i BK).
4. Kontrollon zbatimin në kohë e me cilësi të planeve të sektorëve dhe realizimin e detyrave të tyre.
5. Miraton botimet e institucionit.
6. Miraton rregulloret e redaksive dhe komisioneve që funksionojnë në BKSh.
7. Miraton programin e Shkollës Kombëtare të Bibliotekonomisë.
8. Miraton programin/programet e Qendrës së Trajnimit Bibliotekar.
9. Përfaqëson institucionin para organeve shtetërore dhe në marrëdhëniet me të tretët.
10. Zgjedh, vendos dhe lëviz punonjësit e emërtesës së tij në përputhje me organikën e institucionit dhe me rregullat shtetërore në fuqi.
11. Merr masa disiplinore për punonjësit të parashikuara nga Kodi i Punës dhe kontratat individuale.
12. Bazuar në rregullat dhe ligjet në fuqi, vendos për përgjegjësinë materiale të punonjësve që kanë shkaktuar dëme të pasurisë.
13. Orienton dhe kontrollon punën për aftësimin profesional të punonjësve mbi bazën e një sistemi të programuar kualifikimi.
14. Kontrollon zbatimin e detyrave në fushën e investimeve brenda institucionit.
15. Informon në mbledhjen e Drejtorisë dhe jep llogari para organeve eprore.
16. Për të realizuar drejtimin dhe kontrollin, krijon në rast nevojë, komisione të përkohshme me punonjës të brendshëm ose specialistë të jashtëm.
17. Siguron organizimin e punës në institucion duke mundësuar vijimësinë e funksionimit të tij si institucion i shërbimit publik.